REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2020:025425
Datë:	30.06.2021
Numri i dokumentit:	01939494

Ac.nr.3228/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca – Dula, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Halide Reka, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.XH. nga fshati ... Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.F.M. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi, zyrtar ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.338/20 i datës 12.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.06.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.338/20 i datës 12.04.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.338/20 i datës 12.04.2021, ka vendosur si në vijim:

‘‘I. Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditësit H.XH. nga fshati ... Komuna e Gjilanit, dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 23 vite të përvojës së punës t’ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 315.75 Euro, në vlerë të 75% të pagës bazë, ndërsa në emër të kompensimit të ushqimit, respektivisht për 653 ditë të pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 29.03.2021, t’ia paguajë shumën në lartësi prej 1,621.75 Euro, duke llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 19.02.2020/ data e parashtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive,

2021:087867

të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270 Euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi."

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura përmes përfaqësueses së saj, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa, të prishet aktgjykimi i shkallës së parë, ose çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse me të cilën i ka kundërshturar pretendimet ankimore, me propozim që të refuzohet ankesa si e pabazuar, të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura t'i paguajë paditësit shumën në lartësi prej 208 Euro për përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të padituruës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të saj, me datë 19.02.2020 pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, ka paraqitur padi, ndërsa me parashtresën e datës 29.03.2021 ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin objektiv ndaj të padituruës Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 23 vite të përvojës së punës t'ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 315.75 Euro në vlerë të 75% të pagës bazë, ndërsa në emër të kompensimit të ushqimit, respektivisht për 653 ditë të pranisë në punë, t'ia paguajë shumën në lartësi prej 1,306.00 Euro, pra gjithsej shumën në lartësi prej 1,621.75 Euro, duke llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 19.02.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe atyre të nxjerra në seancat e mbajtura gjyqësore si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.338/20 i datës 12.04.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara dhe nga deklaratat e palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të padituruën, fakt ky i konfirmuar nga kontrata e punës me nr. të prot.407 të datës 01.09.2015, po ashtu nuk ishte kontestuese as formulari i kërkesës apo i ankesës i datës

2021:087867

19.12.2019, me të cilën paditësi i është drejtuar DKA-së në Gjilan, për kompensimin e pagave jubilare, mirëpo e paditura kishte heshtur ndaj një kërkese të tillë, po ashtu nuk ishte kontestuese mes palëve as lista e pagave e lëshuar nga Ministria e Financave e RKS-së, ku paditësi realizon pagë bazë në lartësi prej 421 Euro. Kontestuese në mes palëve ishte vërtetimi me numër 33/21 i datës 29.03.2021 i lëshuar nga SHFMU "Vatra e Diturisë" në fshatin ... dhe atë sa i përket pranisë së mësimdhënësit në punë, mirëpo këtë pretendim të të padituës gjykata nuk e ka marrë për bazë, ngase vërtetimi i lartcekur është dokument publik dhe si i tillë ka fuqi të plotë provuese mbi faktet e pranisë së paditësit në punë për 653 ditë dhe se e paditura me asnjë provë materiale nuk e ka vërtetuar të kundërtën. Lartësinë e kërkesëpadisë në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, gjykata e bazoi nga lista e pagave e lëshuar nga Ministria e Financave e RKS-së, ku paditësi realizon pagë bazë në lartësi prej 421 Euro, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë, për të drejtën e ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë, gjykata e mbështeti në shumën nga 2 euro për secilën ditë të pranisë në punë, rrjedhimisht duke i njohur paditësit shumën prej 1,306.00 Euro. Për bazën juridike të kërkesëpadisë i është referuar dispozitës së nenit 35 par 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë. Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës, gjykata u bazua në në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese, si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditësit i takon e drejta në kompensimin e shpërblimit jubilar dhe të ushqimit, ngase është vërtetuar se i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe ka përvojë pune 23 vite dhe se nga data 18.04.2017 e deri më 29.03.2021 ka realizuar gjithsej 653 ditë pune dhe sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, neni 35.7 parashihet se: *"Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore."*, andaj edhe shuma

2021:087867

prej 1,306.00 Euro është përllogaritur duke shumëzuar numrin e ditëve me vlerën e shujtës ditore prej 2 euro për ditë. Ndërkaq, me dispozitën e nenit 35.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, parashihet se: *"Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë për 10 vite të përvojës së punë në vlerë të 75% të një page bazë, në vlerë për 20 vite të përvojës së punë në vlerë të 50% të një page bazë, në vlerë për 30 vite të përvojës së punë në vlerë të një page bazë, në vlerë për 40 vite të përvojës së punë në vlerë të 150% të një page bazë."* lartësia e pagave është vërtetuar nga lista e pagave e lëshuar nga Ministria e Financave e RKS-së, ku paditësi realizon pagë bazë në lartësi prej 421 Euro, andaj edhe për vlerën e kompensimit të pagave jubilare për 23 vite përvojë punë, me të drejtë iu është njohur shuma në lartësi prej 315.75 Euro, 75% të pagës bazë..

Sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 nuk është nënshkruar nga Komuna e Gjilanit këtu e paditura dhe për këtë arsye nuk prodhon efekt juridik për të njëjtën si punëdhënëse, nuk qëndron kjo për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, e cila është nënshkruar nga autoritetet kompetente, në rastin konkret nga Minisitri i Arsimit dhe kryetari i SBASHK-ut, në nenin 2 par.1 pika 1.2 shprehimisht përcakton se *''Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës''.*

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelsinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, konform nenit 194 të LPK-së si dhe kjo gjykatë i mori parasysh të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe, se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3228/21, me datë 11.06.2021

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca – Dula, d.v.

2021:087867